



**HAL**  
open science

## Tranzicioni dhe shkencat sociale shqiptare: Një qasje kritike.

Enika Abazi

► **To cite this version:**

Enika Abazi. Tranzicioni dhe shkencat sociale shqiptare: Një qasje kritike.. Politikja, 2011, 2, pp.209-215. hal-01319704

**HAL Id: hal-01319704**

**<https://hal.science/hal-01319704>**

Submitted on 22 May 2016

**HAL** is a multi-disciplinary open access archive for the deposit and dissemination of scientific research documents, whether they are published or not. The documents may come from teaching and research institutions in France or abroad, or from public or private research centers.

L'archive ouverte pluridisciplinaire **HAL**, est destinée au dépôt et à la diffusion de documents scientifiques de niveau recherche, publiés ou non, émanant des établissements d'enseignement et de recherche français ou étrangers, des laboratoires publics ou privés.



UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE  
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE POLITIKE

# POLITIKJA

## REVISTË SHKENCORE

NR.2

QASJE NDAJ TRANZICIONIT POLITIK  
SHQIPTAR

REFLEKTIME KRITIKE



MA Enis FITA (Doktorant, UK-Tiranë)	
MA Elisabeta KAFIA (Doktorante, UK-Tiranë)	
“Veçoritë dhe dinamikat e procesit të tranzicionit shqiptar” .....	209
Prof. Ass. Dr. Enika ABAZI (UET)	
“Tranzicioni dhe shkencat sociale shqiptare: Një qasje kritike” .....	215
MA ELONA XHAFERRI (Universiteti i Tiranës)	
“Dilemmas of transition thory to Albania: Is Albania a special case?” ..	227

PROF. ASS. DR. ENIKA ABAZI  
(UET)

## TRANZICIONI DHE SHKENCAT SOCIALE SHQIPTARE: NJË QASJE KRITIKE

Përmbysja e sistemit socialist dhe ideologjisë marksiste rezultoi me mohimin e teorisë sociale të regjimit komunist në Shqipëri. Sigurisht që transformimet sociale dhe shoqërore pas rrëzimit të komunizmit në Shqipëri, e detyruan komunitetin akademik dhe intelektual shqiptar t'u japë përgjigje sfidave urgjente të imponuara nga ndryshimi i menjëhershëm. Megjithatë mbetet e rëndësishme të reflektohet se sa dhe si është mbushur vakumi i krijuar sa hap e mbyll sytë me përmbysjen e komunizmit. Sa janë në gjendje shkencat sociale shqiptare sot të shpjegojnë proceset që po ndodhin, të drejtojnë politikë-bërjen e t'u paraprijnë zhvillimeve të reja? Si ka ndryshuar metoda dhe përmbajtja e shkencave sociale dhe deri në çfarë mase janë ato të afta të komunikojnë dhe debatojnë përtej kontekstit shqiptar? Ky punim synon t'u japë përgjigje këtyre pyetjeve duke privilegjuar një reflektim mbi çështjet metodologjike në shkencat sociale gjatë këtyre njëzet vjetëve në Shqipëri. Një studim i tillë vlerësohet të ketë një rëndësi të veçantë jo vetëm akademike, por para së gjithash praktike, pasi duket se kuptimi i institucioneve dhe interpretimi i proceseve të transformimit të regjimit mbetet një parakusht i domosdoshëm për mirë-funksionimin e tij dhe konsolidimin e rendit demokratik.

Postkomunizmi në vetvete ka një dimension historik, dhe studiuesit duhet të mobilizojnë të gjitha metodat në dispozicion për ta përfshirë atë në konsideratat e tyre. Duke u ndalur në veçanti në analizën e shkaqeve të asaj që unë do ta quaja një tranzicion i munguar në shkencat sociale shqiptare, ky punim fillimisht do të ndalet shkurtimisht në traditën shkencore të trashëguar. Metodologjia e mbështetur në një sistem të unifikuar të shkencës dhe edukimit, si dhe mendësia e krijuar gjatë sistemit të kaluar duket se ende vazhdojnë të ndikojnë zhvillimin e shkencave sociale dhe realitetin postkomunist, që duket se vërtiten në një rreth vicioz që riprodhon në përmbajtje të njëjtin realitet, marrëdhënie sociale dhe mentalitet, ndonëse të ndryshme në formë. Pa një reflektim të tillë mbi çështjet metodologjike studimet postkomuniste kanë mbetur në batakun e studimeve të periudhës komuniste, pasi ndryshimi ndodh kur qartësohen defektet dhe pas interpretimit të tyre mund të shpresohet për adaptimin e një qasjeje dhe produkti shkencor të ndryshëm. Në veçanti do të ndalem kryesisht në influencën e empiricizmit materialist, deskriptivizmit dhe dogmatizmit ideologjik në zhvillimet e shkencave sociale shqiptare dhe pasojat e tyre sot.

### *Studimet e komunizmit dhe tradita shkencore e trashëguar*

Mungesa e studimeve të mirëfillta për periudhën komuniste e bën të vështirë studimin e ndikimit të institucioneve dhe mentaliteteve të së kaluarës

në periudhën postkomuniste. Një studim serioz i periudhës komuniste kërkon një përqendrim të vëmendjes sidomos në çështjet metodologjike. Nevoja e një metode shkencore në shkencat sociale diktohet nga një sërë arsyesh. Realiteti social paraqitet kompleks dhe me ndërthurje të shumta që nuk arrihet të interpretohet vetëm nëpërmjet vëzhgimeve të thjeshta mbi realitetin, pasi sipas Daniel Little (1998) shpesh rezultatet e këtyre të fundit janë iluzive. Zgjedhja dhe përdorimi i metodës së duhur është thelbësore për gjenerimin e dijes dhe përgjithësimin e saj. Për më tepër, studimi i realitetit nëpërmjet një metode shkencore i shërben jo vetëm interpretimit apo parashikimit, por edhe parashtrimit të mundësive njerëzore për veprim e ndërhyrje. Përveç përcaktimit të aftësive tona shpjeguese, metoda e zgjedhur përcakton edhe horizontin tonë etik dhe politik.

Regjimi komunist propagandonte nevojën që gjithçka e për më tepër kërkimi shkencor të karakterizohej nga kërkesat për objektivitet, realizëm si dhe paradoksalisht për çlirim nga paragjykimet e përkushtim ndaj barazisë dhe drejtësisë me qëllim emancipimin e shoqërisë. Paradoksi qëndron në atë se pasqyrimi me objektivitet i realitetit në një shoqëri socialiste jo domosdoshmërisht çon në promovimin e vlerave dhe progresit shoqëror, pasi kjo varet nga mënyra se si kuptohet dhe pasqyrohet 'objektiviteti,' 'realizmi' apo 'emancipimi' në trajtimin e realitetit shoqëror. Kërkimi shkencor në shkencat sociale komuniste huazon nga Marksizmi observimin e një realiteti objektiv, që konsiston në mbledhjen e fakteve empirike dhe 'evidentimin' e përvojës së punës së burrave dhe grave punëtorë e kooperativistë në ndërtim të komunizmit. Një aspekt tjetër i huazuar nga marksizmi është dogmatizmin i cili gjykon 'vërtetësinë' e studimeve nga këndvështrimi i ideologjisë së elitës në pushtet duke u mbështetur në një metodë të vetme, atë marksist-leniniste. Metodologjia e përdorur siguron natyrën politike të interpretimeve dhe shpjegimeve të fenomeneve sociale të cilat i shkonin për shtat legjitimitetit të regjimit komunist që fetishizohej dhe propagandohej si faza e fundit dhe më e emancipuar e zhvillimit të shoqërisë njerëzore.

Aplikimi i marksizmit solli një sërë pasojash që mund të identifikohen lehtësisht në teorinë dhe në praktikën e shkencave sociale shqiptare, dhe që vlen të vihen në dukje pasi duket se kanë ndikim edhe në studimet sociale të periudhës postkomuniste. Adaptimi i empiricizmit i shërbeu instalimit të dogmatizmit në shkencat sociale. Duke ju referuar Steve Smith (1996) empiricizmi nuk është gjë tjetër veçse një qasje dogmatike e realitetit të cilës i mungon pikënisja dhe metoda e duhur për verifikimin e hipotezave dhe përgënjeshttrimin e teorive. Kështu, riprodhimi apo rivlerësimi i së shkuarës është bërë nën optikën e ideologjisë marksiste dhe metodologjisë së realizmit socialist, ku duhej të mbizotëronte lufta e klasave dhe triumfi i heronjve të saj si pjesë e papërgënjeshtreshme e realitetit social. Kështu u inkurajuan studime që krijonin pseudo-heronj si Haxhi Qamili, të stisur si luftëtarë të vegjëlisë apo që vlerësonin Kryengritjen e Fshatarësisë së Shqipërisë së Mesme të vitit 1914 si luftë klasash kundër bejlerëve dhe agallarëve. Në të njëjtën vazhdë deklasheshin dhe për pasojë censuroheshin studime të cilat

ishin në kundërshti me ideologjinë marksiste dhe politikat e regjimit në fuqi.<sup>1</sup>

Empiricizmi dhe ideologjia marksiste kontribuan në instrumentalizimin e dijes shpeshherë nëpërmjet trukimit të realitetit apo “folklorizimit të traditave kulturore” (Doja, 1998) në funksion të legjitimitimit të sistemit, strukturave mbizotëruese të pushtetit siç do të thoshte Michel Foucault (1986) që perkonte me ate komunist, dhe formësimin e një realitet të gënjeshtërt i cili glorifikonte ‘njeriun e ri’ paraqitur si arritje e regjimit komunist, prosperitetin dhe begatinë ekonomike, qëndresën ngadhënjimtare mbi të gjithë armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm, të qenit fanar ndriçues për të gjithë botën për gjithçka, që i shërbente mjaft mirë indoktrinimit të mentalitetit të shoqërisë. Një sërë faktesh e punimesh të së kaluarës ju nënshtruan manipulimit, pasi ato thjesht nuk përmbushnin kriterin ideologjik. Vlen të kujtohet retushimi i dokumentit të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë apo Kongresit të Lushnjës ku protagonistët e karakterizuar si ‘tradhtarë’ u zëvendësuan me mjeshtëri nga ata që politikisht plotësonin standardet dhe mbi to u shkrua historia për këto ngjarje.

Në shumë raste në histori, letërsi, etnografi, arkeologji, etj. instrumentalizimi u materializua nëpërmjet glorifikimit të partikularizmit apo karakterit specifik historik, social dhe kulturor të popullit shqiptar dhe të heronjve të tij popullorë, gjë që në mënyrë të natyrshme kulmonte me vendosjen e socializmit dhe legjitimitimit e lidërshiptit të tij. Nga një vëzhgim i shpejtë i studimeve të shkencave sociale dhe humane në Shqipëri gjatë periudhës së komunizmit mbetet me vend kostatimi i Adam Kuper-it (1996) sipas të cilit në krahasim dhe me zhvillimet e shkencave sociale në vendet e tjera komuniste, studimet e periudhës së komunizmit kanë një prirje të theksuar drejt krijimit të një shkence kombëtare, ku preokupimi kryesor mbetet ri-valorizimi i traditës popullore apo historisë së popullit (shqiptar në rastin tonë), kryesisht nëpërmjet inventarizimit të vlerave pozitive, të lavdishme, të veçanta, ndërkohë që në to mungon thuajse fare trajtimi teorik ose krahasues.

Shkenca sociale kombëtare e krijuar, që unë do ta quaja ‘shqiptare për shqiptarët’, i mungonte dialogu me homologët jashtë vendit dhe për rrjedhojë dhe botimet në revista shkencore jashtë vendit, gjë që solli ‘vetë-izolimim’ intelektual që ndikoi në nivelin e cilësisë së punimeve të botuar dhe problematikave të trajtuara. Një zhvillim i tillë inkurajohej jo vetëm nga adaptimi i një metodologjie kufizuese në studimin e realitetit social, por edhe nga një sërë pengesash të tjera si mungesa dhe ndalimi i literaturës bashkëkohore perëndimore e më vonë edhe asaj lindore në Shqipëri, apo ndalimi i pjesëmarrjes së studiuesve në konferenca e forume ndërkombëtare (Tarifa, 1996), që inkurajoi edhe izolimin fizik të studiuesve shqiptarë.

Ideologjia marksiste duke u paraqitur empirikisht sa natyrale aq edhe e pazëvendësueshme, zhvlerësoi çdo qasje tjetër, duke kushtëzuar atë që Clifford Geertz do ta quante instalimin e “hartës së realiteteve sociale problematike dhe matricën për krijimin e ndërgegjes shoqërore” (1973:220). Ndërkohë që nocioni i legjitimi-

<sup>1</sup> Shih mbi debatin e çështjes Dashnor Kaloçi, “Ja studimet e Enverit dhe Mithat Frashërit për Haxhi Qamilin,” Gazeta Shqiptare 22 Prill 2003.

tetit mbetet problematik, ideologjia merr një rol të rëndësishëm në legjitimimin e pushtetit nëpërmjet inkurajimit të mendimit dhe ligjërimit që natyralizon regjimin politik, duke e bërë atë në mënyrë të pakundërshtueshme të përshtatshëm, *bona fide*, dhe të denjë për respekt.

Më shumë se çdo gjë tjetër botimet divulgative në shërbim jo vetëm të masivizimit të shkencës, por dhe apologjisë së politikës zyrtare ishin me pasoja serioze për nivelin shkencor e metodologjik të punimeve (Egro 2007). Pa u ndalur gjatë në gazetatat dhe revistat e kohës, shkrimet e të cilave nuk trajtojnë veçse probleme të anti-amerikanizmit apo kotësisë së ideologjisë borgjeze-kapitaliste, shembullin më tipik e përbëjnë veprat e liderit komunist, i cili bën ‘analiza’ autodidakte të vetë-administrimit jugosllav, politikave dhe zhvillimeve në Bashkimin Sovjetik, Lindjen e Mesme apo Kinën e largët, të cilat jo vetëm duhet të gjendeshin në bibliotekat e gjithsekujt, por duhet të ishin literatura referuese për studiuesin e mirëfilltë të marrëdhënieve ndërkombëtare, ashtu si dhe për studentin apo dhe kooperativistin e thjeshtë kur t’i duhej të demaskonte në mbledhjet e kolektivit hrushovianët, kinezët dhe tradhtarët e radhës të doktrinës marksiste.

Për shumë disiplina të shkencave sociale apo shkolla të mendimit në Shqipëri mungon pothuajse fare tradita ndryshe. Duke ju referuar fatit të sociologjisë gjatë socializmit (Tarifa, 1996), por që është rasti edhe për shkencat politike e marrëdhëniet ndërkombëtare, antropologjinë sociale, psikologjinë, etj. mungon tradita pasi ato konsideroheshin ose ‘të panevojshme’ ose ‘borgjeze të dëmshme.’ Tradita e shkencave sociale komuniste ekziston e zhvilluar në nivel kërkimor dhe institucional vetëm për filozofinë marksiste-leniniste dhe ekonominë politike dhe kjo kryesisht e socializmit, ku kanë ekzistuar programe studimi në universitet si dhe ka pasur qendra e institute të kërkimit shkencor. Mungesa e studimeve të realitetit social në nivele të ndryshme, të individit, të grupit apo dhe të gjithë shoqërisë, krijoi përshtypjen e një realiteti social pa probleme duke i shndërruar në spekulative shumë studime të aspekteve sociale dhe ekonomike të shoqërisë shqiptare. Të tilla ishin raportet e kongreseve të Partisë së Punës të cilat bënë një analizë të të gjitha aspekteve të jetës në Shqipëri që gjithsesi paraqitej si e mbushur me suksese dhe realizime spektakolare siç u konsiderua sigurimi i bukës, dritës dhe çelikut në Kongresin e 8-të të Partisë së Punës, që në të njëjtën kohë trumbetohej si emancipim i shoqërisë shqiptare që nuk e njihnte kthimin mbrapa.

Vlen të theksohet se, marksizmi shkencor si teori, në ndryshim nga marksizmi utopist apo ideologjia dhe praktika e asociuar me të, ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në mënyrën se si duhen analizuar, conceptualizuar, dhe shpjeguar proceset shoqërore në një këndvështrim historik dhe rolin e forcave sociale në to. Metodologjia e marksizmit shkencor në shpjegimin e një procesi, fenomeni apo ngjarjeje shoqërore kërkon zbulimin e shkakësisë duke evituar asocimin ‘realist’ dhe empiricist të variabëlve të observuar. Kjo perspektivë lejon ngritjen e hipotezave të verifikueshme. Në nivel ndërkombëtar teoria e marksizmit shkencor ka pasur një ndikim të padiskutueshëm në shkencat sociale, krahas ndikimit të ideve të Weberit, sidomos në Shkollën e Frankfurtit që lindi në periudhën midis dy luftërave

botërore si një përpjekje për adaptimin e qasjeve kitike në shkencat sociale, me përfaqësues ndikues si Max Horkheimer dhe Theodor Adorno, për të kulmuar me Jurgen Habermas (1984) që solli një kuptim jo instrumentalist të arsyes e dijes dhe metodën jo-pozitivistike në shkencat sociale (Held, 1980; Raymond, 1981). Michel Foucault (1970, 1986) sjell në vëmendje se dija është kontingjent i kushteve specifike historike, marrëdhënieve dhe strukturave përkatëse të pushtetit, ndërsa Emmanuel Wallerstein (1974, 1980, 1989) 'ri-zbulon' ndërvarësinë e sistemit ekonomik sot dhe alienimin si kategori dhe fenomene reale sociale që duhet të korrigjohen me qëllim emancipimin e shoqërisë njerëzore. Paradoksisht, pikënisja e qasjeve kritike buron nga qasjet neo-marksiste për të vijuar me tej me qasjet konstruktiviste dhe strukturaliste në shkencat sociale.

Këto ndikime të marksizmit shkencor në nivelin ndërkombëtar kanë pasur një jehonë të papërfillshme në shkencat sociale shqiptare gjatë periudhës komuniste ndonëse ironikisht të mbizotëruar nga metoda e 'realizmit' socialist dhe ideologjia marksiste. Adaptimi verbërisht i metodës së 'realizmit' socialist nga shkencat sociale shqiptare inkurajoi në to një deskriptivizëm të kotësive empirike, me mungesa të konceptimit të dialektikës midis konkretes dhe abstraktes, të të përgjithshmes dhe të veçantës që qëndron në themel të organizimit të realitetit social. Me këtë 'zgjedhje' shkencat sociale komuniste shqiptare nga njëra anë i mohuan vetes kuptimin e shkakësisë në thelb të sistemeve, strukturave dhe proceseve sociale, gjithsesi jo gjithnjë të observueshme, të cilat vënë në lëvizje apo kufizojnë veprimet individuale, por edhe iniciojnë procese sociale të cilat nuk qeverisen nga ligjësi të caktuar të cilat gjithsesi nuk janë të rastësishme. Nga ana tjetër, studiuesit shqiptare nuk kanë qenë në gjendje të marrin parasysh se sistemet, strukturat dhe proceset sociale gjenerojnë marrëdhënie të pushtetit, dominimit, shfrytëzimit apo rezistencës, të cilat favorizojnë disa ndërkohë që disfavorizojnë disa të tjerë, dhe që vlerësimi kritik i tyre qëndron në bazë të emancipimit të shoqërisë. Pra, thënë ndryshe, realiteti paraqitet kompleks, ai rezulton nga marrëdhënia e ndërsjellët e agjentëve dhe strukturës, të cilët ndikojnë reciprokisht njëri-tjetrin dhe vetë mjedisin social. Ndaj interpretimi i fenomeneve sociale mbetet sa i rëndësishëm aq edhe i vështirë pa përdorimin e metodës së duhur.

Ndërkohë qasjet empiriciste të adaptuara nga shkencat sociale shqiptare rezultojnë problematike për nivelin e njohjes dhe objektivitetit që ofrojnë në teorizim në rast se nuk synojnë interpretimin me rigorozitet të shkakësisë. Kështu, ndërkohë që nuk mund të mohohet rëndësia e të dhënave empirike në shkencat sociale, Stanley Lieberman (1989) do të insistonte në rëndësinë e një të menduari që mban parasysh shkakësinë dhe që në të njëjtën kohë nuk refuzon arsyetimin sasior. Ai insiston në thellimin që i duhet bërë të kuptuarit të shkaqeve dhe mekanizmave, duke kritikuar mendimin e përciptë mbi metodat empirike të cilat sipas mendimit tim janë karakteristike për shumicën e studimeve të problematikës së transformimeve post-socialiste. Sigurisht një studim rigoroz shkencor qoftë nisur edhe nga premisa empirike kërkon mbajtjen parasysh të asaj që, Alexander L George and Andrew Bennett do ta quanin ndjekje të procesit (process-tracing). Një metodë



e tillë ka për qëllim zbulimin e lidhjes ndërmjet shkaqeve të mundshme dhe rezultateve të observimit. Ndjekja e procesit nënkupton shqyrtimin dhe interpretimin e fakteve historike, dokumenteve arkivore, transkripteve të intervistave dhe burimeve të tjera që duket se kanë lidhje me ngjarjen në vëmendje, krahas rezultateve të observimeve, për të parë në se shkakësia e observuar çon në përpunimin e një hipoteze teorike apo është thjesht një ngjarje e radhës pa ndonjë rëndësi të veçantë (George and Bennett 2005: 6). Shumë shkollarë kanë argumentuar se është e mundur që të ofrohet evidencë në favor apo disfavor qoftë edhe të një pretendimi të vetëm shkakësor duke bërë të mundur gjenerimin kështu të arsyetimeve rigorozë për çështje të rëndësishme të transformimeve sociale në një periudhe të ndryshimit të regjimeve.

Duket se trashëgimi i një tradite shkencore të mbarsur me probleme, kryesisht empiricizmit dhe dogmatizmit, edhe në vitet e tranzicionit përbën një oportunitet të munguar të adaptimit të mendimit kritik dhe alternativave teorike, aq të domosdoshme për studimin e një realiteti social me fenomene dhe procese heterogjene, që do t'i kishte shërbyer transformimit të shkencave sociale shqiptare në përgjithësi dhe realitetit shqiptar në veçanti drejt zhvillimeve bashkëkohore.

### *Tranzicioni dhe studimet e tij*

Tranzicioni shqiptar i ngjan një procesi Sizifian që nuk i duket as fillimi as fundi. Ndërkohë që transformimet sociale duken komplekse, lidhjet shkakësore të një tërësi ndryshimesh dhe konsekuencash që pasojnë mbeten ende të errëta. Në vetvete, transformimet sociale nënkuptojnë një zhvillim social të ndërthurur me shumë të papritura dhe kthim mbrapa, me krijim dhe shpërbërje të institucioneve, kompromiseve dhe strukturave sociale, me ndryshueshmërinë e politikave të shtetit dhe partive, sjelljen strategjike të grupeve të ndryshme sociale dhe proceseve të shumëllojshme dhe të ndërvarura sociale. Ndryshime të tilla bëjnë të domosdoshme zhvillimin e një paradigme të re në shkencat sociale me qëllim dhënien e përgjigjeve ndaj sfidave të ndryshimit të regjimit dhe paraprirjen e zhvillimeve që do të çonin drejt konsolidimit të një rendi demokratik. Tranzicioni shqiptar ka nevojë për një studim të qenësishëm të mirë-mbështetur në kuadrin e një metodologji dhe qasjeje të re shkencore. Ndërkohë që idetë e vjetra në baze të shkencave sociale janë zhvleftësuar, idetë e reja nuk kanë marrë një formë të qartë.

Duket se studimi i një periudhe jo shumë të largët në kohë, ka mbetur kryesisht në kuadrin e kujtimeve, botimit të dorëshkrimeve të atyre që deri pak kohë më parë quheshin të deklasuar apo ri evokimit të ngjarjeve të të kaluarës kryesisht atyre që kanë të bëjnë me marrëdhëniet brenda ish-partisë në pushtet dhe mënyrën e ushtrimit në praktikë të diktaturës së proletariatit dhe luftës së klasave që mbushin faqet e të përditshmeve kombëtare dhe lokale. Rëndësia e evokimit të realitetit të së kaluarës në mënyrë thjesht fotografike, kataloguese, si dhe ajo e ri-shkrimit, rishikimit ose ristrukturimit të të kaluarës, mbetet e dyshimtë në dobinë e saj në se nuk shoqërohet me interpretimin e proceseve dhe marrëdhënieve sociale të ushtrimit dhe legjitimitetit të pushtetit si dhe shfaqjes dhe pasojave të tyre në

shoqërinë komuniste apo me mënyrën se si ato përthyen në shoqërinë postkomuniste shqiptare. Reflektimi mbi të kaluarën komuniste apo më në veçanti për historinë e institucioneve në bazë të organizimit të shoqërisë komuniste dhe mënyrës së legjitimit të tyre do t'i shërbente kuptimit të mënyrës se si institucionet shoqërore funksionojnë në ditët tona dhe se si ato favorizojnë, kushtëzojnë apo pengojnë zhvillimet sociale në periudhën e transformimit të regjimit.

Janë të pakta studimet që i referohen periudhës komuniste për identifikimin e pasojave të komunizmit në metodologjinë e shkencave sociale shqiptare (Tarifa, 1996; Doja, 1998; Hoti, 2003; Egro, 2007). Ndërkohë, mungesa e një reflektimi serioz mbi studimet e periudhës së komunizmit dhe metodologjinë e përdorur, rezulton të ketë lënë pasojat të cilat marrin formë të ndryshme në studimet bashkëkohore. Studimet të cilat evokojnë periudhën që lamë pas në pjesën më të madhe synojnë rishikimin, rishkrimin apo ristrukturimin e historisë, etnografisë, ligjit zakonor apo gjuhës shqipe, proces i cili duket se mbart një dozë të lartë të asocimit me politikën dhe ideologjinë e elitës në pushtet. Kështu për shembull, debati mbi ditën e çlirimit të Shqipërisë nga pushtuesit nazistë, ka vënë përballë historianët e vendit të cilët duket se frymëzohen në diskutimet dhe shkrimet e tyre nga nevoja për t'u distancuar nga e kaluara komuniste ose për t'u asociuar në grup. Sigurisht në një proces të tillë rëndësi ka marrë dhe rivlerësimi i shumë fakteve të cilat paraqiten si versioni legjitim i të kaluarës, ndërkohë që të tjera kanë kaluar në një pozicion të marginalizuar. Kështu mund të kujtojmë rivlerësimin e luftës të quajtur nacional-çlirimtare e cila nuk është më vetëm çlirimtare, por është bërë dhe një luftë civile midis forcave komuniste e nacionaliste për pushtet. Kështu, post komunizmi në shkencat sociale, ashtu si edhe në rastin e vendeve të tjera lindore (p.sh. Kaneff, 1998; Appadurai, 1981), është konceptuar si konfrontim i interpretimeve konfliktuale mbi të kaluarën komuniste ku historia, gjuha, e drejta zakonore, apo kultura popullore shihen si entitete të negociueshme, pjesë e rivalizimit, kundërshtimit dhe debatit politik midis grupimeve të ndryshme politike dhe aspekt i rëndësishëm për justifikimin e reformave gjatë këtyre njëzet viteve të transformimit të regjimit. Vërtetësia e studimeve, si dhe në të kaluarën, bëhet në funksion të preferencave politike të elitës së radhës në pushtet duke ruajtur kështu dogmatizmin në përmbajtje.

Një problem i studimeve sociale të periudhës post komuniste është metodologjia që ato përdorin, e cila ndikohet në një masë të madhe nga tradita shkencore komuniste, duke trashëguar empiricizmin dhe deskriptivizmin me karakter dogmatik dhe instrumentalist. Kështu në se i referohemi një sërë studimesh të kryera në Shqipëri pas rrëzimit të komunizmit ato mbështeten kryesisht në observime dhe anketime të ndryshme ku mbizotëron fetishizimi i faktit empirik dhe mungesa e analizës kritike. Qasja empirike, në mënyrë të thjeshtuar, përqendrohet në vrojtime të sjelljes së aktorëve të ndryshëm në shoqëri, matjes dhe numërimit të variabëlve në kuadrin e popullsisë, përdorimin metodave sasiore statistikore në zbulimin e korrelacioneve dhe asocimeve ndërmjet variabëlve sociale. Në fund të fundit një qasje e tillë synon të zbulojë shkakësinë në shoqërinë njerëzore duke përllogaritur

koeficientet e regresionit për një grup variabëlsh të pavarur të cilët shikohen si shpjegues të sjelljes së variabëlve të varur, apo korrelacionin ndërmjet disa variabëlve, apo evidentimin e rregullshmërisë së asocimit midis një grup variabëlsh. Një qasje të tillë Andrew Abbot do ta quante “paradigma e variabëlve”, sipas së cilës puna kryesore qëndron tek zbulimi i variabëlve sociale dhe përcaktimi i marrëdhënieve ndërmjet tyre (Abbott 1999 : 222). Të tilla janë në pjesën më të madhe studimet e kryera nga ‘think tanket’ shqiptare për probleme që kanë të bëjnë me çështje nga më të ndryshme, si për shembull integrimi i Shqipërisë në strukturat Euro-Atlantike, decentralizimi, liritë dhe të drejtat njerëzore e të minoriteteve, fenomene si gjakmarrja apo çështjet e pronësisë. Në studimet që trajtojnë çështjen e integritimit Euro-Atlantik, rezulton se në masën 94-96 për qind shqiptarët janë pro integritimit në këto struktura, sigurisht lëvizja e lirë apo niveli i lartë i korrupsionit shtetëror janë disa nga arsyet e preferuar në shpjegim të situatës, ndërkohë pothuajse në asnjë studim nuk ndalet në arsyet e mungesës së mendimit ndryshe apo në kundërshtim të shqiptarëve dhe organizimeve të tyre politike, ekonomike apo dhe civile. Në themel një paradigme empiriciste sjell kufizime epistemologjike dhe ontologjike dhe është e destinuar të mbetet pa një metodë të mirëfilltë kërkimore që do ta pajiste kërkimi me instrumentet e nevojshme për zbulimin e shkakësisë.

Një karakteristikë tjetër e studimeve shqiptare të periudhës post-socialiste është rendja mbas ngjarjeve sensacionale që në qoftë se do t’i nënshtroheshin ndjekje të procesit (process tracing) do të rezultonin të zakonshme dhe pa ndonjë rëndësi të veçantë. Mjafton, të kujtojmë debatet e shumta për tre çështje tashmë të mirënjohura edhe nga publiku mbarë shqiptar: historia e Skënderbeut e Oliver Schmitit<sup>2</sup>, identiteti European apo oriental i shqiptarëve<sup>3</sup> apo standardi i gjuhës shqipe e dhe vendi i dialekteve. Debatet kanë pasur të përbashkët ndjeshmërinë dhe përkushtimin për mbrojtjen e vlerave dhe të simbolikës kombëtare, duke mbetur në thelb emocionale, ku reflektohet njëanshmëri, sektarizëm, e madje ideologjizim i çështjeve të diskutuara, ndërkohë që pak ose aspak është diskutuar mbi natyrën dhe rëndësinë e referencave të përdorura, mbi metodologjinë e vlerësimit dhe kontekstualizimit të këtyre referencave, rëndësinë e pluralitetit të metodave dhe teorive në studimin e proceseve sociale apo historike.

Për rrjedhojë, njëlloj si artikujt në gazetat e përditshme dhe punimet shkencore janë të dobëta, të karakterit politiko-publicistike, dhe për më tepër të paafta për të parashtruar një dialog konstruktiv e kritik në nivel ndërkombëtar. Në shumë studime duket se ideologjia marksiste është zëvendësuar nga ajo kombëtare apo nacionaliste. Çështjet e trajtuara politizohen, dhe studimet nuk

<sup>2</sup> Artan Puto (18.01.2009) “Nga Skënderbeu mitik në atë historik”, Gazeta Shekulli. Preng C. Lleshi (15.03.2009) “S’është mitik, por historik” Gazeta Shekulli. Një përpjekje modeste në këtë drejtim mund të quhet punimi i Adrian Ndrecës, Kur “Skënderbeu” Nuk Asht Historia e Skënderbeut.

<sup>3</sup> “Kaskada e opinioneve” (26 prill 2006) Tirana Observer. Shih gjithashtu: <http://www.forumishqiptar.com/showthread.php?t=64263&page=14>

janë në gjendje të ofrojnë një kontribut të mirëfilltë shkencor, por në shumë raste krijojnë dasi dhe armiqësi të panevojshme që nuk përbëjnë ndonjë kontribut shkencor. Në se do t'i referohesha Izber Hotit "si dhe më parë nuk trajtohet e kaluara për arsye shkencore dhe fisnike, por për para dhe motive të tjera, që nuk ndikojnë fare në përparimin tonë kombëtar, por as në përparimin tonë shoqëror në përgjithësi" (2003: 272). Studimet divulgative duket se janë trashëguar edhe në ditët tona. Shkenca bëhet në median e shkruar dhe vizive ku debatuesit dinë gjithçka për çdo gjë dhe debatet 'shkencore' mbeten të politizuara dhe ideologjizura pa qenë të afta të identifikojnë problemet që shqetësojnë shoqërinë shqiptare në periudhën post komuniste, le më pastaj ti analizojnë ato në mënyrë shkencore e të ofrojnë zgjidhje për to (Hoti, 2003; Egro 2007). Jo në pak raste studimet e periudhës post komuniste në Shqipëri trashëgojnë empiricizmin sociologjik apo deskriptivizmin historik dhe një logjikë konformiste qoftë politike qoftë ideologjike për marrëdhëniet institucionale, ekonomike, politike, sociale apo kulturore deri edhe gjuhësore dhe produktin e tyre social. Një qasje e tillë shoqërohet me pasoja jo vetëm etike por edhe politike, të shprehura rëndom në qëndrime autoritative, unilaterale apo stigmatizuese, në interes të dikujt apo të një ideologjie të caktuar, që në thelb i shërbejnë konsolidimit të një pushteti të cilësuar. Adaptimi i qasjes refleksive e cila tërheq vëmendje me mënyrën se si duhet kuptuar formësimi i interesave politike, përdorimi i kontekstit historik dhe vlerave mbizotëruese të projektuara nga elitat në formate dijësore të formalizuara dhe që nënvleftësojnë alternativa të tjera që nuk i interesojnë politikës në pushtet apo që kërkon sanksionim prej pushtetit, janë të papërfillshme në studimet bashkëkohore shqiptare ndonëse njëzet vjet kanë kaluar nga shembja e izolimit shkencor. Adaptimi i një analize sistematike kritike mund të na surprizojë. Si shembull, ndër të paktët, përballja nëpërmjet një analize sistematike kritike me të dhëna demografike, burime historike dhe etnografike në lidhje me moshën mesatare të martesës dhe normat e përgjithshme e fertilitetit në Shqipëri, dimensionin ideologjik i mitit se shqiptarët bëjnë shumë fëmijë brenda familjes të ashtuquajtur patriarkale që përcillet dhe projektohet zakonisht në shkrimet akademike, shtyp dhe mendimet stereotip, bëhen të pavlefshme pasi rezulton se ajo që është paraqitur si fakt empirike nuk është asgjë tjetër por një aktivizëm i fortë kulturor (Doja, 2010). Kështu, adaptimi i një qasje kritike do t'u mundësonte shkencave sociale sot jo vetëm shpjegimin por edhe parashikimin e produktit social të tranzicionit ndërkohë që do t'i kishte shërbyer edhe politik-bërjes për të evituar debatet stigmatizuese dhe përjashtuese.

Tranzicioni si fenomen është kompleks dhe i ndërthurur me shumë procese të tjera sociale dhe si i tillë nuk mund të shpjegohet vetëm mbështetur në një vëzhgim të thjeshtë të realitetit. Fenomenologjia e tranzicionit sikundër edhe ajo sociale në përgjithësi nuk janë krejt të rastësishme sikundër dhe nuk qeverisen nga ligjësi objektive në nivelin që kjo është e vërtetë për fenomenet e natyrës (Little 1993). Për të kuptuar sistemet, strukturat dhe proceset në brendësi të realitetit social që formësojnë tranzicionin dhe në të njëjtën kohë kushtëzojnë individin

dhe sjelljen e tij, nuk mjafton konsensusi apo gjykimi i përbashkët për çka është 'politikisht korrekt', apo përdorimi i metodave pozitiviste karakteristike për shkencat e natyrës mbështetur thjesht në observime empirike dhe anketime gjerësisht të përdoruar në studimin e fenomenologjisë së tranzicionit. Me interes është identifikimi i mekanizmave sociale shkakësore që më pas do të na shërbenin për të shpjeguar proceset dhe fenomenet sociale të cilat mund të identifikohen nëpërmjet studimeve krahasimore apo dhe përdorimit të teorive të ndryshme sociale.

### *Konkluzione*

Shkencat shqiptare nuk kanë kohë për të humbur madje janë tepër të vonuara. Sot shkencat sociale po kalojnë një transformim historik i cili qëndron në njohjen e rëndësisë së historikut të proceseve dhe institucioneve sociale në kuptimin e funksionimit të tyre në të tashmen. Në një nivel më abstrakt, ne mund të përcaktojmë një seri pohimesh ontologjike që kanë lindur si rezultat i këtyre debateve: në lidhje me qenësinë e ligjeve universale midis fenomeneve sociale; për qenësinë e rrugëve të ndryshme dhe alternativave strukturale që qëndrojnë në bazë të transformimeve të rëndësishme historike; ndërgjegjësimi për ekzistencën e heterogjenitetit të thellë të proceseve dhe influencave në kohë dhe hapësirë; vëmendje në ndikimin e thellë të të papriturave në ndryshimet historike; vëmendje tek fleksibiliteti i organizatave dhe institucioneve sociale; dhe përpjekjeve për të kapërcyer ndarjen midis proceseve sociale në nivelin mikro dhe makro. Të gjitha këto çështje janë në themel të transformimit fundamental të qasjeve empiriciste. Skepticizmi tashmë gjerësisht i pranuar nga komuniteti akademik rreth mungesës së rregullshmërive sociale përbën një sfidë të rëndësishme ndaj qasjeve empiriciste. Theksi që vihet në mekanizmat shkakësorë vë në dukje rëndësinë e qasjeve analitike, reflektive apo kritike në disfavor të atyre empiriciste të mbështetura në observime apo anketime simpliste.

### *Bibliografia*

Abbot, Andrew (1999) *Department & discipline : Chicago Sociology at One Hundred*. Chicago, IL: University of Chicago Press.

Appadurai, Anarita (1981) "The past as a Scarce Resource", in *Man* (n.s.), vol 16 (2): 201-219.

Cox, Robert (1981) "Social Forces, States and the World Order: Beyond International Relations Theory", *Millennium: Journal of International Studies*, 10 (2), pp126-155.

Cox, Robert (1987) *Production, Power and World Order: Social Forces in the Making of History*, New York: Columbia University Press.

Dashnor Kaloçi, "Ja studimet e Enverit dhe Mithat Frashërit për Haxhi Qamilin," *Gazeta Shqiptare* 22 Prill 2003.



Doja, Albert (1998) "Évolution Et Folklorisation Des Traditions Culturelles." *East European Quarterly* 32(1): 95–126.

— — —. "Fertility Trends, Marriage Patterns and Savant Typologies in Albanian Context." *Journal of Family History* 35, no. 4 (2010): 346–67.

Egro, Dritan (2007) *Historia dhe Ideologjia. Një qasje kritike studimeve osmane në historiografinë modern shqiptare*, Tiranë: Maluka.

Kuper, Adam (1996). *Anthropology and Anthropologists: the modern British school*. (Third revised and enlarged edition) Routledge: London.

Geertz, Clifford (1964) "Ideology as a Cultural System" in *Ideology and Discontent* eds. David Apter. pp. 47–76. New York: Free Press.

Geuss, Raymond (1981) *The Idea of a Critical Theory: Habermas and the Frankfurt School*. Cambridge University Press.

George, Alexander L., and Andrew Bennett (2005) *Case Studies and Theory Development in the Social Sciences, BCSIA Studies in International Security*. Cambridge, Mass.: MIT Press.

Habermas, Jürgen (1984) *The Theory of Communicative Action*. translated by Thomas McCarthy, Cambridge: Polity Press.

Held, David (1980) *Introduction to Critical Theory: From Horkheimer to Habermas*. Berkeley CA: University of California Press.

Habermas, Jürgen (1987) *Knowledge and Human Interest*. Cambridge: Polity Press.

Hoti, Izber (2003) *Në Udhëkryqet e Historisë dhe të Historiografisë Shqiptare*. Prishtinë: Instituti i Historisë.

Kaneff, Deema (1998) "Negotiating the Past in Post-Socialist Bulgaria," *Ethnologia Balkanica* 2: 31-45.

"Kaskada e opinioneve" (26 prill 2006) *Tirana Observer*.

Lleshi, Preng C. (15.03.2009) "S'është mitik, por historik" *Gazeta Shekulli*

Lieberson, Stanley (1987) *Making It Count: The Improvement of Social Research and Theory*. Berkeley, CA: University of California Press.

Little, Daniel (1998) *Microfoundations, Method and Causation: On the Philosophy of the Social Sciences*. New Brunswick, New Jersey: Transaction Publishers.

Ndreca, Adrian (2008) *Kur "Skënderbeu" Nuk Asht Historia e Skënderbeut*, Tiranë, Onufri.

Puto, Artan (18.01.2009) "Nga Skënderbeu mitik në atë historik", *Gazeta Shekulli*.

Smith, Steve, (1996) "Positivism and Beyond," in Steve Smith, Keen Both, and Marysia Zalewski eds, *International Theory: Positivism and Beyond*, Cambridge: Cambridge University Press.

Tarifa, Fatos (March 1996) "Neither "bourgeois" nor "communist" science: Sociology in communist and post-communist Albania" *Communist and Post-Communist Studies* 29 (1): 103-113.

Wallerstein, Emmanuel (1974) *The Modern World-System, vol. I: Capitalist Agriculture and the Origins of the European World-Economy in the Sixteenth Century*. New York/London: Academic Press.

—————. (1980) *The Modern World-System, vol. II: Mercantilism and the Consolidation of the European World-Economy, 1600-1750*. New York: Academic Press.

—————. (1989) *The Modern World-System, vol. III: The Second Great Expansion of the Capitalist World-Economy, 1730-1840's*. San Diego: Academic Press.